



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. të datës 11.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 14.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. e datës 11.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 14.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 09.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 31.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 Korriku - Faza II” me nr. të prokurimit 616-23-8041-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë se disa nga kërkesat e dosjes së tenderit duhet të ndryshohen pasi që si të tilla (sipas parashtruesit) ato janë në kundërshtim me parimin për mos diskriminim/favorizim në kuptim të nenit 7 të LPP. Duke u referuar te pretendimet e tij ankimore, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7 dhe 69 të LPP si dhe nenin 70 të RRPP.

Konkretisht pretendimet ankimore të parashtruesit janë formuluar si në vijim: *“per realizimin e puneve te parapara ne paramases pere kete aktivite te prokurimit jane te mjaftueshem ky personel udheheqes te OE sic jane Nje Inxhinier I diplomuar I Arkitektures ose master I Arkitektures, Nje Inxhinier I Diplimuar Ndertimtatisë – Konstruktive Ose Master, Nje Inxhinier I diplomuar Makinerise ose Master, Nje Inxhinier I Diplomuar Elektroteknikes pse Master, Nje Inxhinieri I diplomuar Ndertimtarise-Hidroteknike ose Master. Permes ketij personeli profesional te lartecekur OE kontraktues doti realizoje punimet e kontraktuara dhe sipas nenit 22 Kushteve te pergjithshme te Kontrates Menaxheri I kontrates dhe Organet mbikeqyrese doti kontrollojne verifikojne pranojne punet e realizuara ne perputhshmeri me karekteristikatspecifikat e parapara ne paramase. Andaj kerkojme qe ri-korigjim te dosjes se tenderit te percaktohen kriteret jo diskriminuese”*.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 16.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Fillimisht duhet cekur që parashtruesi lidhur me aktivitetin e njëjtë të prokurimit me datë 03.08.2023 ka parashtruar edhe një kërkesë për rishqyrtim kundër dosjes së tenderit. Me datë 10.08.2023 Autoriteti Kontraktues e kishte miratuar këtë kërkesë si pjesërisht të bazuar. Në ndërkohë Autoriteti Kontraktues ka publikuar edhe dy (2) B54 Formular për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuar përmes të cilave është ndryshuar dosja e tenderit dy (2) herë dhe atë me datë 10.08.2023 si dhe me datë 14.08.2023. Në anën tjetër parashtruesi ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 11.08.2023 ashtu që nuk ka marrë parasysh fare ndryshimet në dosjen e tenderit që janë bërë me datë 14.08.2023 respektivisht tri (3) ditë pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim. Për më tepër pretendimet ankimore të kësaj kërkesë për rishqyrtim janë pothuajse të njëjta me pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim të datës 03.08.2023.

Përmes nenit 59 paragrafit 59.1 të RRPP përcaktohet se *“Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliohen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit”*. Në rastin konkret kërkesa për rishqyrtim është drejtuar kundër dosjes së tenderit e cila është ndryshuar pasi paraqitjes së kërkesës. Për më tepër pretendimet ankimore të parashtruesit Autoriteti Kontraktues tanimë i ka shqyrtuar dhe mbi to ka vendosur përmes vendimit të datës 10.08.2023 për shkak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit të datës 03.08.2023 lidhur me aktivitetin e njëjtë të prokurimit. Në këtë mënyrë është gjetur se kjo kërkesë për rishqyrtim nuk është në përputhje me nenin 59 paragrafin 59.1 të RPP. Njëkohësisht Autoriteti Kontraktues konfirmon se qëndron prapa vendimit të datës 10.08.2023 përmes të cilit janë trajtuar pretendimet e njëjta ankimore që janë parashtruar edhe me kërkesën e datës 03.08.2023.

Përmes nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafit b) të RRPP përcaktohet se Autoriteti Kontraktues do të refuzojë një "kërkesë për rishqyrtim nëse kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 59.1 të kësaj rregullore".

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin b) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.